



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE

Tetor 2020

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2020

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020  
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [amanda.kojku@financa.gov.al](mailto:amanda.kojku@financa.gov.al)

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** \_\_\_\_\_ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** \_\_\_\_\_ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit \_\_\_\_\_ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit \_\_\_\_\_ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave \_\_\_\_\_ 5
4. Bilanci i Pagesave \_\_\_\_\_ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar \_\_\_\_\_ 7
6. Kredia për Ekonominë \_\_\_\_\_ 8
7. Oferta e Parasë \_\_\_\_\_ 9
8. Depozitat sipas burimeve \_\_\_\_\_ 10

**SEKTORI FISKAL** \_\_\_\_\_ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar \_\_\_\_\_ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal \_\_\_\_\_ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** \_\_\_\_\_ **13**


# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2020 arriti në 108.5 përqind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Tetor 2020 ishte 2.0 përqind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Tetor 2020 ishte 105.36 lekë për dollarë dhe 123.98 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Tetor 2020 shënuan kuotën 0.40 përqind për ato 12-mujore; 0.28 përqind për depozitat 6-mujore; 0.13 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.42 përqind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.41 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.36 përqind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.412.669 milionë lekë në muajin Tetor, duke shënuar një rritje prej rreth 8.6 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2020-ës rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 0.3 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Tetor 2020 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 66.2 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej 107.6 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Tetor 2020, arritën në rreth 347.359 miliardë lekë ose afërsisht 98% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 413.547 miliardë lekë ose rreth 90% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Tetor 2020 ishte 2.0%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1.3%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Tetor 2020 shënoi rritje prej 0.2% krahasuar me muajin e kaluar. Gjithashtu në muajt paraardhës, shtator dhe gusht 2020, IÇK shënoi rritje mujore me 0.4 dhe 0.2 përqind përkatësisht. Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Tetor 2019 shënoi rënie mujore prej 0.2%, në krahasim me muajin paraardhës.



Krahasuar me muajin Tetor 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4.9%, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1.5% secili, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0.9%, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.8%, etj.

**Ndryshimi mujor i indeksit është 0.2%.** Krahasuar me muajin Shtator 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 0.6%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.3%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.2% secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.1 %.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 4.3%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.8%, “Shëndeti” me 0.4% dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0.3%.

Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 0.4%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0.2%, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Shëndeti” me 0.1% secili.

Tab - 1 **Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2019	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.4	1.3	1.3	1.4	1.2
2020	1.5	1.2	2.1	1.9	2.1	1.8	1.4	1.3	1.5	2.0		


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Tetor 2020, arriti në 123.98 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me -0.03 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Tetor, një euro u këmbye me 123.93 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Tetor 2020 arriti në 105.36 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.14 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 106.16 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Tetor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një zhvlerësim ndaj monedhës europiane në masën 0.71 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 5.46 përqind. Në përgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit është nxitur nga rënia relative e rritjes ekonomike në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme të ekonomisë, tërmetit të ndodhur në nëntor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.85 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave



Gjatë muajit Tetor 2020, normat e interesit të depozitave me afat 1 dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.42 dhe 0.40 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.28 dhe 0.13 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 1, 3, 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.01, 0.03, 0.08 dhe 0.03 pikë përqindje.

Duke krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 1, 3, 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.31, 0.30, 0.07 dhe 0.04 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Tetor 2020, arritën përkatësisht kuotën prej 5.36 dhe 5.41 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie prej 0.74 dhe 0.62 pikë përqindje përkatësisht. Gjithashtu, krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie prej 0.58 dhe 1.21 pikë përqindje përkatësisht.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Tetor 2020 arritën nivelin 1.73 përqind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.02 pikë përqindje dhe rënie vjetore prej 0.34 pikë përqindje.





## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2020 rezultoi pozitiv dhe në zgjerim të lehtë të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth 0.3 milionë euro. T3 2020-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente rreth 193 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 17 milionë euro (ose 10%). Thellimi i deficitit korrent, në masën më të madhe është ndikuar nga ngushtimi i suficitit tregtar në shërbime, në reflektim të rënies së të ardhurave nga “udhëtimet”, për shkak të Covid-19. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 157 milionë euro, rreth të njëjtit nivel të një viti më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare shënojnë 129 milionë euro dhe mundësojnë mbulimin e deficitit korrent në masën 67%.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë tremujorit të tretë 2020, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 2.757 milionë euro, në rënie vjetore me rreth 25%. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 193 milionë euro, rreth 10% më i lartë krahasuar me një vit më parë. Ecuria e deficitit korrent reflekton ngushtimin e suficitit tregtar në shërbime e kompensuar pjesërisht nga tkurrja e deficitit tregtar në mallra. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës në T3-2020 (Fig.6).

- (i) bilanci tregtar me -794 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 347 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -30 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 284 milionë euro.






## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit Tetor 2020, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 110.528 milionë lekë krahasuar me muajin Tetor të vitit 2019. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me 98.386 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 3.986 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 4.904 milionë lekë e bankës paradepozituese.




Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.412.669 milionë lekë në muajin Tetor 2020, duke shënuar një rritje prej rreth 112.215 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 8.6 përqind.

Gjithashtu në muajin Tetor 2020, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 5.043 milionë lekë ose 0.4 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Tetor 2020 arriti në rreth 592.283 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 23.929 milionë lekë, ose rritje me rreth 4.21 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (53.5%) dhe monedhave të huaja (46.5%).



Gjatë muajit Tetor 2020, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 60.2 përqind ose 356.625 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.09 përqind ose rreth 207.830 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.37 dhe 2.25 përqind apo 14.044 dhe 13.335 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Tetor 2020, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.51 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 25.39 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.10 përqind dhe rreth 1.0 përqind.

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 331.491 milionë lekë në fund të muajit Tetor 2020. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Tetor 2020 ka shënuar rritje mujore prej 0.06 përqind dhe rritje vjetore prej 1.67 përqind, duke arritur nivelin 23.5 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.11 përqind, dhe rritje vjetore prej 2.79 përqind, duke shënuar nivelin 30.7 përqind.

Fig-11




**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Tetor 2020, kanë shënuar rritje vjetore prej 24.370 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 79.6 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Tetor 2020 shënuan rritje prej 39.835 milionë lekë në krahasim me muajin Tetor 2019. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 81.4 përqind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Tetor 2020, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 81.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 13.3 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 79.6 përqind dhe rreth 17.7 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 80.4 përqind e totalit.

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 869.555 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (169.195 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (20.684 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (19.944 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.798 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



**Përberja e depozitave Tetor '20**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Tetor 2020, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.081.178 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 2.959 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 64.206 milionë lekë.


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar- Tetor 2020 janë mbledhur rreth 347.359 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 413.547 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 343.665 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 57.111 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 34% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 226.168 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 18.477 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 80.419 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 16.087 miliardë lekë (ose rreth 94% e planit për periudhën Janar- Tetor 2020).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 343.665 miliardë lekë, 63.187 miliardë lekë (18% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 29.318 miliardë



lekë (8.5%) për shpenzime interesi, 36.668 miliardë leke (11%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 914 miliardë lekë (0.3%) për subvencione, 141.705 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 46.741 miliardë lekë (14%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 23.776 miliardë lekë (7%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 77% (shpenzime personeli), 73% (shpenzime për interesat), 72% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 59% (subvencione), 76% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 87% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 96% (shpenzimet e tjera) përkundrajt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 62%, ndërsa financimi i huaj është 71% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar- Tetor 2020 ishin rreth 347.359 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 325.864 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 16.086 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Tetor 2020 (mld Lekë) Revenues during October 2020 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Tetor '20 October '20	Tetor '19 October '19	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	12.69	12.65	0.33
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.56	0.55	1.72
	Akcizat (Excise)	4.00	3.95	1.16
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.30	2.51	-8.19
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.67	3.09	-13.6
	Taksat nacionale (National Tax)	3.20	3.14	2.01

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Tetor - 2020

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: October - 2020

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej -66.2 miliardë lekë gjatë periudhës Janar- Tetor 2020, u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Tetor 2020, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 39.125 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 45.901 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Tetor 2020, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 36.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 37.7 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 8.1 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1																
Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	September
<b>Tetor</b>	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	<b>0.2</b>	0.04	-0.1	-0.1	-0.1	<b>0.1</b>	1.8	1.6	2.1	1.3	<b>2.0</b>	<b>October</b>
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2		0.12	0.1	0.1	0.0		1.9	1.7	1.8	1.4		November
Dhjetor	0.9	1.0	1.1	0.8		0.19	0.2	0.2	0.1		2.2	1.8	1.8	1.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**  
Exchange rate

Monedha	2017	2018	2019	2020										Currency
				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
				January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	
<i>Mesatarja e periudhës</i>														<i>Average of period</i>
USD	112.56	108.43	109.94	110.06	111.94	112.08	115.43	113.80	110.39	108.51	104.73	105.21	105.36	USD
EURO	133.25	123.45	122.17	122.08	122.13	124.31	125.40	123.91	124.22	124.02	123.80	124.02	123.98	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>														<i>In the end of period</i>
USD	111.10	107.82	108.64	110.71	111.38	118.75	113.55	111.76	110.95	105.61	104.33	105.99	106.16	USD
EURO	132.95	123.42	121.77	122.13	122.74	130.66	123.49	124.33	124.34	123.95	124.09	124.05	123.93	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2017	2018	2019	2020												In percent
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October			
<b>Norma e depozitave</b>															Deposits rates	
12-M	0.80	0.75	0.43	0.40	0.42	0.44	0.45	0.38	0.40	0.42	0.30	0.43	0.40	0.40	12-M	
6-M	0.56	0.56	0.41	0.48	0.27	0.35	0.48	0.49	0.24	0.30	0.21	0.36	0.28	0.28	6-M	
3-M	0.29	0.30	0.17	0.40	0.14	0.17	0.16	0.12	0.17	0.30	0.17	0.16	0.13	0.13	3-M	
1-M	0.82	0.62	0.72	0.81	0.76	0.70	0.32	0.43	0.40	0.43	0.42	0.43	0.42	0.42	1-M	
<b>Norma e huasë</b>															Lending rates	
12-M	6.79	6.34	6.82	6.73	6.26	6.56	6.06	6.48	6.20	6.36	5.63	6.03	5.41	5.41	12-M	
6-M	8.12	8.16	6.34	6.87	6.78	6.75	5.91	7.01	6.67	5.81	5.26	6.10	5.36	5.36	6-M	
<b>Norma e letrave me vlerë</b>															Securities rates	
Bono thesari 1/															Treasury bills 1/	
3-M	-	-	-	-	1.29	-	1.30	1.54	1.20	-	0.70	-	-	-	3-M	
6-M	-	-	-	1.50	-	-	-	1.81	-	-	-	1.30	-	-	6-M	
12-M	2.63	1.43	1.69	1.77	1.87	1.98	2.05	2.16	1.98	1.74	1.66	1.71	1.73	1.73	12-M	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>36,012</b>	<b>71,182</b>	<b>104,160</b>	<b>133,224</b>	<b>160,581</b>	<b>194,902</b>	<b>233,673</b>	<b>271,025</b>	<b>308,234</b>	<b>347,359</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	Të ardhura nga ndihmat	204	785	1,118	1,690	1,706	2,297	3,073	3,561	4,397	5,409	Grants
II.	Të ardhura tatimore	34,315	66,979	97,001	123,391	149,690	182,355	219,123	254,771	289,234	325,864	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	23,535	46,931	69,240	85,512	103,342	125,133	149,934	175,899	200,593	226,168	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,493	22,929	31,850	39,229	47,922	58,235	69,888	81,309	92,901	105,600	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,255	4,506	9,086	10,852	11,443	13,701	15,434	17,592	19,943	22,248	Profit Tax
3	Akcizat	3,399	6,750	10,215	12,609	15,809	19,750	23,898	28,312	32,119	36,122	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,459	6,109	8,457	11,045	13,544	15,925	19,135	23,044	25,767	28,440	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,478	5,682	8,272	10,046	12,376	14,713	18,183	21,694	25,403	28,739	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	451	955	1,359	1,733	2,247	2,809	3,396	3,946	4,460	5,019	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,229	2,943	4,035	5,682	6,996	10,236	13,076	14,927	16,744	18,477	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	265	576	763	1,106	1,409	2,248	3,003	3,518	3,917	4,354	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	16	237	288	306	331	344	349	360	370	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	957	2,352	3,035	4,288	5,281	7,657	9,729	11,060	12,467	13,753	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,551	17,105	23,727	32,197	39,353	46,986	56,113	63,945	71,897	81,219	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	8,205	14,780	20,538	27,797	34,013	40,480	48,158	54,817	61,657	69,532	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,339	2,324	3,187	4,400	5,338	6,309	7,572	8,580	9,593	10,887	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,492	3,418	6,041	8,143	9,185	10,250	11,477	12,693	14,603	16,086	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			1,398	1,398	1,398	1,398	1,398	1,398	1,398	1,398	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	986	2,223	3,170	5,072	5,682	6,380	7,191	7,930	9,206	10,201	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>32,517</b>	<b>67,507</b>	<b>106,948</b>	<b>148,804</b>	<b>187,632</b>	<b>233,389</b>	<b>283,061</b>	<b>324,167</b>	<b>367,645</b>	<b>413,547</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	Shpenzime Korrente	31,951	64,876	95,490	132,167	166,536	193,785	234,588	269,728	305,932	343,666	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,184	12,428	18,700	24,959	31,356	37,750	44,231	50,457	56,780	63,187	Personnel expenditures
1	Paga	5,301	10,650	16,028	21,399	26,893	32,395	37,929	43,233	48,614	54,121	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	877	1,753	2,631	3,507	4,393	5,269	6,147	7,012	7,891	8,747	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,289	6,487	9,004	11,485	13,056	15,102	19,646	22,056	24,546	29,318	Interest
1	Të Brendshme	3,123	4,766	6,598	8,275	9,442	10,919	14,349	16,141	18,043	20,049	Domestic
2	Të Huaja	1,165	1,721	2,406	3,210	3,614	4,183	5,297	5,916	6,502	9,269	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,431	6,063	9,389	13,113	8,986	21,007	25,321	28,548	32,679	36,668	Operational & Maintenance
I.4	Subvecionet	64	126	183	288	337	389	442	617	802	914	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	13,486	27,854	40,287	54,299	67,954	82,955	98,437	113,579	128,384	143,061	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,290	20,441	29,980	40,069	50,499	61,784	73,773	85,335	96,605	107,675	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	2,715	6,712	9,606	13,446	16,659	20,291	23,486	27,066	30,423	34,029	Health insurance
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	2,499	6,841	10,674	13,573	17,200	22,340	29,454	35,216	41,219	46,741	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	2,995	5,077	7,252	14,450	19,967	14,242	17,056	19,254	21,522	23,777	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	43	87	135	4,769	8,000	390	430	514	613	712	Unemployment insurance benefits
I.8	Transferime Kapitale							818	818	818	818	
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca					7,678	11,572	11,742	11,794	11,931	11,952	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	567	2,632	11,458	16,637	21,097	28,032	35,914	41,828	48,964	57,111	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	-1	646	8,038	10,440	13,839	18,140	23,724	27,461	31,356	36,815	Domestically financing
2	Financimi Huaj	568	1,901	3,255	5,980	6,883	9,423	11,683	13,678	16,908	19,562	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara											Arrears
V.	DEFICITI	3,495	3,675	-2,788	-15,580	-27,051	-38,487	-49,388	-53,142	-59,411	-66,188	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-3,495	-3,675	2,788	15,580	27,051	38,487	49,388	53,142	59,411	66,188	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-2,416	-1,680	5,859	730	13,059	-56,488	-45,329	-40,624	-35,089	-27,224	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	2	29	58	69	73	192	208	213	216	223	Privatization receipts
2	Hua-marrije e brendshme	5,408	8,635	10,735	27,939	33,339	37,004	38,048	37,170	38,064	45,665	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,826	-10,344	-4,934	-27,278	-20,353	-93,684	-83,586	-78,006	-73,368	-73,113	Others
V.3	Huaj	-1,078	-1,995	-3,071	14,850	13,993	94,975	94,717	93,766	94,500	93,413	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	364	1,565	3,507	4,517	5,811	87,783	89,203	89,789	91,743	93,900	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	184	364	767	910	972	1,121	1,146	1,144	1,439	1,535	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-441	-1,257	-111	-485	98	241	1,172	1,810	1,602	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,448	-3,119	-5,320	-11,718	-13,557	-16,257	-18,077	-20,545	-22,403	-25,439	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore				22,162	22,224	23,350	23,350	23,350	23,350	23,350	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2020**

Table of investments 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	
<b>Financim i brendshëm</b>	- 2,416	- 1,680	5,859	730	13,059	- 56,488	- 45,329	- 40,624	- 35,089	- 27,224	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	69.1	45.72	210.2	4.69	48.27	-146.77	-91.78	-76.44	-59.06	-41.13	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	- 1,078	- 1,995	- 3,071	14,850	13,993	94,975	94,717	93,766	94,500	93,413	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	30.9	54.28	-110.2	95.31	51.73	246.77	191.78	176.44	159.06	141.13	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-3,495</b>	<b>-3,675</b>	<b>2,788</b>	<b>15,580</b>	<b>27,051</b>	<b>38,487</b>	<b>49,388</b>	<b>53,142</b>	<b>59,411</b>	<b>66,188</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2020  
CUSTOMS REVENUES 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	
Taksë doganore	451	955	1,359	1,733	2,247	2,809	3,396	3,946	4,460	5,019	Customs Duties
TVSH	7,434	15,763	22,596	28,718	36,078	44,648	54,057	62,609	71,475	81,084	V.A.T
Akcizë	3,399	6,750	10,215	12,609	15,810	19,750	23,898	28,312	32,119	36,122	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	246	465	661	710	791	921	1,085	1,208	1,375	1,503	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>11,530</b>	<b>23,933</b>	<b>34,832</b>	<b>43,771</b>	<b>54,926</b>	<b>68,128</b>	<b>82,435</b>	<b>96,075</b>	<b>109,429</b>	<b>123,728</b>	<b>Total</b>

TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

TVSH	4,059	7,166	9,254	10,510	11,844	13,588	15,831	18,701	21,426	24,515	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,255	4,506	9,086	10,852	11,443	13,701	15,434	17,592	19,943	22,248	Profit Tax
